



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Analizë teksti B (5)

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore;
Viti / Semestri: Viti III, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyruar
Programi i studimit: Bachelor në gjuhën angleze
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT –së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme: Kursi Analizë Teksti 5 synon të përgatisë studentët për nivelin më të avancuar të njohjes së gjuhës angleze (CPE), duke konsoliduar dhe thelluar të katër aftësitë gjuhësore: leximin, dëgjimin, të folurit dhe të shkruarit. Ai synon gjithashtu pasurimin e fjalorit, ndërtimin e stilit gjuhësor dhe zhvillimin e kompetencave për komunikim akademik.

Objektivat specifike:

1. Të lexojnë dhe kuptojnë në thellësi tekste nga fusha të ndryshme akademike dhe profesionale.
2. Të zhvillojnë dëgjimin përmes materialeve autentike të lidhura me detyra konkrete.
3. Të përmirësojnë aftësitë e shkrimit në nivelin Proficiency, duke u fokusuar në strukturë, stil dhe qëllim komunikimi.
4. Të aftësohen në përdorimin e gjuhës së folur për ndërveprim të avancuar, negociata dhe shprehje të ideve të ndërlikuara.
5. Të zgjerojnë fjalorin përmes deduksionit kontekstual dhe analizës stilistike (formale dhe jo-formale).

Rezultatet e pritshme

1. Studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë dhe interpretojnë tekste komplekse nga fusha të ndryshme akademike, të komunikojnë në mënyrë të rrjedhshme në regjistrë të lartë, dhe të prodhojnë shkrime të sakta dhe të përshtatshme për kontekste të avancuara.
2. Ata do të jenë të aftë të analizojnë stilin, nënkuptimet dhe strukturën e gjuhës, si dhe të përballen me sukses me teste në nivelin më të lartë të kompetencës në gjuhën angleze.